30/07/2019

SHENJTORI I DITES.



E martë, 30 korrik 2019

Apostujt Sila, Silvani, Epeneti, Kriski nga të 70-t. Oshënare Angjelina Araniti (Shqiptare).

– Oshënare Angjelina Araniti (Shqiptare) –

Ishte e bijë e princit shqiptar Gjergj Arianitit dhe motra e Donikës, gruas së Gjergj Kastriotit. Angjelina u martua me despotin e Serbisë, Stefan Brankoviçin dhe lindën dy fëmijë, Maksimin dhe Joanin.

Mbas vdekjes së Stefanit, Angjelina u vesh murgeshë në Manastirin e Krushedolit, duke ia përkushtuar jetën lutjeve dhe veprave bamirëse, saqë populli e thërriste “Nënë Angjelina”.
Fjeti në fillimet e shekullit të 16-të në Manastirin e Krushedolit, ku ruhen edhe sot lipsanet e saj mrekullibërëse. Kisha e kanonizoi shenjtore dhe e nderon kujtimi e saj më 30 korrik.



Mitropolia e Shenjtë Korçë/facebook